



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.27.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË
MEDIAVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Maj 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderren, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Emine Fazliu, e mbështetur nga, Faruk Rrahmani (Udhëheqës Ekipi), Lindita Ajeti dhe Mazlumsha Sejfadini (anëtar të Ekipit auditues).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	10
4 Qeverisja.....	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	23


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë, Kryetarin e Komisionit, Kryeshafen Ekzekutive si dhe stafin e tyre për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmorr në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë e reflekton qasjen e paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 3 Tetor 2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:




Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 - Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do të adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet që dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Shembull i një aktivitet, mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyra financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

KPM ka përgatitë dhe prezantuar PVF në harmoni me kërkesat ligjore dhe standardet e raportimit financiar. Cilësia e PVF në përgjithësi ishte e mirë, dhe të gjitha kërkesat e raportimit ishin plotësuar. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk ndërlidhen me PVF ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 - **Opinion i Pamodifikuar**).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare të KPM-së duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren nr. 03/2014 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat që PVF, të janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe janë dorëzuar në MF;
- Kërkesa që PVF të përgatiten në gjuhën Shqipe dhe Serbe;
- Kërkesa që PVF të përgatiten në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Kërkesat e rregullores 01/2013 - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Përveç hartimit të PVF-ve, nga KPM kërkohet të adresoj obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Dorëzimi i raporteve të rregullta tremujore në Kuvend;
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi obligimet e dorëzuara në MF;
- Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të MFK-së; dhe
- Raporti vjetor i performancës.

Në kontekst të PVF-ve dhe raportimit të jashtëm ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

KPM ka treguar gatishmëri të plotë për të adresuar rekomandimet tona të vitit 2013, por një çështje në lidhje me numrin e të punësuarve në listën e pagave nuk ishte adresuar. Kjo nuk ka ndonjë ndikim domethënës në funksionimin e KPM-së. Ne e inkurajojmë menaxhmentin që të merr masat dhe veprimet e duhura për ti adresuar edhe rekomandimet e këtij viti.

Përshkrimi

KPM kishte ndërmarrë veprime për t'i adresuar rekomandimet e dhëna, për të siguruar përmirësimin e fushave kryesore të menaxhimit financiar dhe kontrollit. KPM ka përgatitur një plan veprimi për të siguruar se rekomandimet do të adresohen brenda periudhës së specifikuar.

Raporti jonë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar me tri rekomandime. KPM kishte arritur të adresoj plotësisht dy rekomandime. Rekomandimi i tretë në lidhje me dallimin e numrit të të punësuarve në listën e pagave me numrin e lejuar me ndarjet buxhetore nuk ishte adresuar, sepse Komisioni për buxhet dhe financa i Kuvendit nuk kishte mundur të përfshirjen e anëtarëve të bordit të KPM-së të jenë pjesë e përbashkët me stafin administrativ. Kjo nuk ka ndikim në funksionimin e KPM-së pasi pozitat janë të financuara.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrolle kyçe nëpër sistemet kyçe financiare, ne kemi konstatuar se, kontrollet në disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që KPM të ketë, vlerë të dobët për parandë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi më i mirë në inkasimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme si dhe funksionalizimin e sistemit e-Pasuria.

Për vitin 2015 KPM-së, nuk i është ndarë buxhet për projekte kapitale edhe pse KPM-ja ka hyrë në obligime kontraktuale. Kjo paraqet një sfidë për arritjen e objektivave për vitin 2015, për zgjidhjen e të cilës nevojitet të bëhen kërkesa dhe diskutime të vazhdueshme me Ministrinë e Financave, me qëllim që kjo çështje të trajtohet me rishikim të buxhetit për vitin 2015.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	1,483,539	1,415,174	1,370,440	752,987	668,403
Të hyrat vetjake të bartura				45,323	240,388
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,483,539	1,415,174	1,370,440	707,664	428,015

Buxheti final, është më i ulët për 68,365€ se buxheti fillestar. Ky shkurtrim i buxhetit është sipas vendimit të qeverisë nr. 07/172 për shkurtrim të buxhetit në kategorinë mallra & shërbime dhe shërbimeve komunale në vlerë 62,365 apo 15%. Ndërsa teprica e konstatuar prej 6,000€ është zvogluar me kërkesë të Thesarit pas konstatimit të tepricës së mjeteve në kategorinë paga dhe mëditje.

Fakti që buxheti është shpenzuar 97% tregon një performancë të mirë si në realizimin e projekteve kapitale ashtu edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike-shpenzimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,483,539	1,415,174	1,370,440	752,987	668,403
Pagat dhe Mëditjet	373,769	367,769	331,777	296,475	232,619
Mallrat dhe Shërbimet	395,770	336,405	335,977	430,097	418,804
Shërbimet komunale	20,000	17,000	17,000	17,086	16,980
Investimet Kapitale	694,000	694,000	685,686	9,329	0

Shpenzimet nëpër kategori në raport me buxhetin në përgjithësi ishin të kontrolluara mirë. Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Te pagat dhe mëditjet kemi një tepricë buxhetore në vlerë prej 35,992€ përkundër rritjes së pagave për 25% dhe zvogëlimit të buxhetit fillestar prej 6,000€. Një faktor që ka ndikuar në mos shpenzimin e plotë të pagave dhe mëditjeve është mos emërimi i dy anëtarëve të bordit nga ana e Kuvendit të Kosovës, e për të cilët ishte planifikuar buxheti.
- Niveli i shpenzimeve të mallrat & shërbimet dhe shërbimet komunale ishte pothuajse i plotë nga fakti që buxheti ishte shkurtuar në këto kategori për 15% dhe kjo kishte ndikuar që obligimet në fund vit të jenë më të larta. Krahasuar me vitin paraprak shpenzimi në mallra dhe shërbime ishte për 94,120€ më i ulët.
- Te investimet kapitale buxheti ishte shpenzuar 99% për vitin aktual, që paraqet një performancë të mirë. Mirëpo, projektet kapitale që i ka filluar KPM në vitin 2014 (Arkiva elektronike dhe Sistemi Digjital) janë projekte afatmesme dhe kërkojnë fonde për dy-tri vite për kompletimin e tyre.
- Në kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) dhe PIP janë paraparë fonde për projektin e sistemit digjital për vitin 2014 dhe 2015 (nga 400,000€). Por në buxhetin e vitit 2015 KPM-së nuk i është ndarë fare buxhet për këtë projekt përkundër që ishte lidhur kontrata.
- Projekti i arkivës elektronike nga KPM ishte planifikuar të realizohet për tri vite përkundër që si projekt në PIP dhe KASH-i nuk ishte i përfshirë për vitet 2015 dhe 2016. KPM ka lidhur kontratën për tërë vlerën e projektit por duke e specifikuar me një nen të veçantë se kontrata për vitet në vijim do të zbatohet nëse ju ndahet buxhet, dhe se nuk kanë obligim ndaj kontraktorit nëse nuk ju ndahet buxhet për vazhdimin e projektit.

Sipas menaxhmentit të KPM-së, Ministria e Financave është zotuar se me rishikim të buxhetit do të ndajë mjete për vazhdimin e të dy projekteve.

Tabela 3. Të hyrat e KPM-së në tri vite (në €)

Përshkrimi	Të hyrat e planifikuara	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Të hyrat	339,847	325,162	401,972	221,290

Në vitin 2014, KPM ka planifikuar të realizoj të hyra nga licencat e operatorëve në vlerë prej 339,847€. Inkasimi i të hyrave në vitin 2014 ishte në vlerë prej 325,162€ përfshirë edhe pagesat e viteve paraprake, gjobat dhe kamatat. Kurse inkasimi i të hyrave nga licenca në vitin 2014 ishte 253,785€ ose 75% nga ajo që ishte planifikuar.

Nga tabela shihet një rënie e inkasimit të të hyrave nga viti paraprak e cila rrjedhë nga mos efikasiteti i mbledhjes së të hyrave që ka rezultuar me rritje të llogarive të arkëtueshme. Kjo është shtjelluar më thellësisht në pjesën 4.2.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Të hyrat

Përshkrimi

KPM-ja ka një gamë kontrollesh që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, duke përfshirë edhe reflektimin e tyre në PVF. Megjithatë, ekziston një nevojë për përmirësim në disa procese të cilat do të mbështesin plotësinë e mbledhjes së të hyrave.

KPM në fund të vitit 2014 ka aprovuar rregulloren e re ku ndër ndryshimet kryesore janë shtyrja e afatit të pagesës deri në fund të marsit dhe mos aplikimi i kamatës tash e tutje, por marrja e licencës operatorëve.

Rregullorja në fuqi për vitin 2014, ka paraparë që licencat, operatorët audio vizual duhet të paguajnë deri me 31 Janar të vitit aktual. Në rast të mospagesës me kohë, KPM aplikon një kamatë prej 1% dhe rastet kur nuk bëhet pagesa, procedohen në gjykatë.

Çështja 1. Mekanizma jo shumë efikas për mbledhjen e të hyrave – Prioritet i lartë

E gjetura Në vitin 2014, KPM kishte planifikuar të realizoj të hyra nga licencat e operatorëve në vlerë prej 339,847€, bazuar në regjistrin e operatorëve që janë aktivë. Deri në fund të janarit 2014, KPM ka realizuar të hyra në vlerë prej 109,659€ apo 32%, në afatin kohor siç e parasheh rregullorja në fuqi. Nga kjo vërehet se kishte vonesa në inkasimin e të hyrave dhe mekanizmat aktual për inkasimin e të hyrave, ishin treguar jo efikas.

Rreziku Mungesa e funksionimit efikas të mekanizmave për mbledhjen e të hyrave dhe ekzistimi në vazhdimësi i llogarive të arkëtueshme, lëndëve nëpër gjykata, rrezikojnë që një pjesë e tyre të mos inkasohet fare. Procedurat në gjykata zgjasin shumë dhe praktika e deritanishme ka treguar se KPM duhet të forcoj mekanizmat e inkasimit të të hyrave para se lëndët të procedohen në gjykatë. Kjo ka refleksion edhe në trajtim jo të barabartë të operatorëve në njërën anë dhe ndikon edhe në uljen e nivelit të të hyrave për Buxhetin e Kosovës.

Rekomandimi 1 Kryetari i Komisionit duhet të monitoroj zbatimin e rregullores së re në praktikë për të siguruar respektimin e afatit të rishikuar, më 31 mars, për inkasimin e të hyrave. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime shtesë për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuar të viteve paraprake.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Ne i kemi testuar proceset e prokurimit të zhvilluara në KPM, gjatë vitit 2014 dhe kemi identifikuar çështje të cilat janë trajtuar në kuadër të këtij raporti.

Për të vlerësuar rregullsinë e pagesave, ne testuam shpenzimet dhe proceset e prokurimit nga kategoria mallra-shërbime dhe investime kapitale. Ne testuam vlerën prej 78,945€ nga kategoria mallra dhe shërbime dhe 685,704€ nga kategoria investime kapitale.

Çështja 2 – Kriteret në dosjen e tenderit nuk ishin specifike –Prioritet i mesëm

E gjetura Në dosjen e tenderit “Shërbime të Përkthimit” janë kërkuar dëshmi për staf profesional në fushën e përkthimeve, së paku për dy përkthyes për të dy gjuhët, serbe dhe angleze, por pa e specifikuar për çfarë dëshmish bëhet fjalë. Sipas kësaj nuk është shumë i qartë se me çfarë dokumente duhet të plotësohet ky kriter.

Rreziku Mungesa e qartësisë të kriterëve në dosjen e tenderit ju mundëson operatorëve të sjellin dëshmi të ndryshme ose edhe jo relevante.

Marrja e CV-ve si përmbushje e kriterit nuk është ndonjë dëshmi e fortë për shkakun që ato plotësohen nga vetë kandidati. Prandaj, përderisa nuk precizohen qartë kriteret në dosjen e tenderit, ekziston rreziku të lidhen kontrata me operatorë ekonomik që nuk kanë aftësitë e duhura profesionale për të kryer shërbimet në mënyrë cilësore.

Rekomandimi 2 Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se departamenti i prokurimit me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit, çdo kriter duhet ta precizojë qartë për të konfirmuar ofrimin e shërbimit të një standardi të duhur.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Gjatë testimeve tona në fushën e shpenzimeve jemi fokusuar te shpenzimet, te të cilat janë identifikuar diferenca të konsiderueshme nga viti paraprak. Shpenzimet e derivateve për gjenerator për vitin 2014 janë në vlerë prej 15,811€, përderisa në vitin 2013 ato ishin 3,294€. Në kuadër të këtyre shpenzimeve kemi testuar një pagesë, në vlerë prej 7,550€.

Diferenca e këtyre shpenzimeve ishte si rezultat i ndrrimit të objektit dhe hapësirës më të madhe të objektit të ri.

Çështja 3. Pranimi i derivateve për gjenerator pa komision të pranimit – Prioritet i mesëm

E gjetura Në rastin kur pranohet një mall që shpenzohet (siq është rasti me derivatet për gjenerator) dhe nuk ka evidenca dhe mundësi të konstatohet shpenzimi i tij, atëherë organizata gjatë pranimit të mallit duhet të shtojë nivelin e kontrollit duke krijuar një komision të pranimit.

Gjatë testimit të kësaj lënde ne vërejtëm se pranimi i derivateve në një sasi prej 6000 litrave nga ana e KPM-së ishte bërë pa komision të pranimit. Pranimi ishte bërë vetëm nga zyrtari i logjistikës.

Rreziku Fakti që bëhet fjalë për një sasi mjaft të madhe të naftës ekziston rreziku që të mos ofrohet e tërë sasia. Prandaj pranimi pa komision të pranimit, e rritë rrezikun që malli të mos pranohet në sasinë dhe cilësinë për të cilën bëhet pagesa.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komisionit duhet të siguroj që në rastet kur ekziston rreziku që malli që ofrohet mund të mos jetë në sasinë dhe cilësinë e duhur të formojë komisione të pranimit për të shtuar masat e kontrollit.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel qendror nga KPM kanë të bëjnë me a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listen e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundëshme që mund të paraqiten përmes formularëve dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Ne rishikuam listat e pagave si dhe krahasuam të dhënat e prezantuar nga Thesari - SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar mostra, duke përfshirë dosjet e personelit. Bazuar në këtë kemi konstatuar se KPM, ka vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve).

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Pasuritë dhe obligimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Kemi rishikuar procesin e menaxhimit të pasurive dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së pasurisë nëse janë mbajtur në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Të dhënat e prezantuara në PVF janë në përputhje me evidencat e regjistrit kontabel, regjistrit që mbanë organizata për pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet.

Ne analizuam evidencat për të verifikuar nëse ato po mbahen siq e kërkon rregullorja. KPM mban regjistrin kontabel dhe regjistrin e organizates për pasuritë nën 1,000€.

Çështja 4. Sistemi “e - Pasuria” dhe menaxhimi i depos – Prioritet i lartë

E gjetura Rregullorja nr. 02/2013 thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-Pasuria”.

KPM edhe pse e ka të instaluar softwerin e “e-Pasurisë”, ende nuk ka arritur ta funksionalizoj duke qenë se edhe stafi nuk ishte trajnuar. KPM kishte bërë përpjekje për të kontaktuar MAP-in si kontraktues dhe kompaninë e softuerit e-Pasuria, por nuk kishin arritur të sigurojnë trajnim. Pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe stoku evidentohen në Exel.

E gjetura Po ashtu, rishikuar procesin e menaxhimit të depos me fokus të veçantë në analizimin e procesit të hyrje-daljeve të materialit nga depoja. Me rastin e pranimit të mallit nga zyrtarët e ndryshëm të KPM-së nga depoja nuk plotësohet ndonjë formular me të cilën dëshmohet se malli që del nga depoja është pranuar nga zyrtari i caktuar.

Rreziku Mos funksionalizimi i sistemit “e-Pasuria” rritë rrezikun që pasuria me vlerë nën 1,000€ e raportuar në PVF të jetë e mbivlerësuar apo nënvlerësuar si rezultat i gabimeve dhe moskalkulimit të duhur të zhvlerësimit. Gjithashtu, menaxhimi i depos në këtë mënyrë tregon se kontrollet janë joefektive dhe si pasojë organizata ballafaqohet me rrezikun e humbjeve dhe keqpërdorimit, për shkakun që malli mund të mos përdoret për qëllimet e institucionit.

Rekomandimi 4 Kryetari i Komisionit duhet të ndërmer veprime konkrete me qëllim që të siguroj fillimin e përdorimit të sistemit “e-Pasuria”, në mënyrë që të shfrytëzohen shërbimet e këtij sistemi. Fillimisht duhet kërkuar nga MAP-i si kontraktor i këtij sistemi të siguroj trajnime për stafin për aplikimin e këtij sistemi. Me funksionalizimin e këtij sistemi mundësohet edhe menaxhimi i depos dhe evitohen mangësitë aktuale.

4.4.2 Trajtimi i Llogarive të arkëtueshme

Përshkrimi

KPM, krijon të hyra nga licencimi i operatorëve që ofrojnë shërbime audio-vizuele. Mos pagesa me kohë nga operatorët, krijon të arkëtueshme. Të arkëtueshmet e pambledhura pastaj procedohen në gjykatë dhe raportohen si pasuri kontingjente nga KPM.

Çështja 5. Mungesë efikasiteti në mbledhjen e të arkëtueshmeve –Prioritet i lartë

E gjetura Të arkëtueshmet e KPM-së, me 31 dhjetor 2014 ishin në vlerë prej 97,603€. Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mund të shihen edhe nga trendi në rritje në tri vitet e fundit i rasteve të paraqitura në gjykatë. Llogaritë e arkëtueshme që janë shëndrruar në pasuri kontingjente janë rritur nga 89,917€ sa ishin në vitin 2012 në 248,487€ në vitin 2014.

Rreziku Mos inkasimi i të arkëtueshmeve prej vitit në vit rezulton në një humbje të drejtpërdrejtë financiare për KPM-në dhe Buxhetin e Kosovës.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komisionit duhet të rishkojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës dhe të konfiskimit të pajisjeve.

4.4.3 Trajtimi i obligimeve

Përshkrimi

Nga PVF-të e vitit 2014, KPM ka prezantuar obligime në vlerë prej 46,798€, deri sa në vitin 2013 obligimet ishin në vlerë prej 8,675€. Rritja e obligimeve në këtë vit është si rezultat i mungesës së fondeve pas shkurtimit të buxhetit nga qeveria në kategoritë mallra& shërbime dhe shërbime komunale prej 15%. Obligimet e mbetura kryesisht i takojnë muajit nëntor dhe dhjetor e ku për mallra&shërbime janë 42,280€ dhe 4,518€ janë për komunal.

Raportimi i obligimeve në thesar ishte i plotë, i saktë dhe në kohën e duhur.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

NjAB ka hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit i cili është aprovuar nga menaxhmenti. Me plani të auditimit janë paraparë të kryhen gjashtë auditime për vitin 2014. Plani ishte hartuar bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe prioriteteve. Janë paraparë të auditohen fushat e: prokurimit, financave, monitorimit të medias, administratës, licencimit, dhe një auditim me kërkesë (ad hoc).

NjAB, gjatë vitit kishte kryer gjashtë auditime, duke e realizuar në plotësi planin vjetor. Në këto raporte, NjAB kishte dhënë 15 rekomandime për përmirësim. Auditori i brendshëm ka mbuluar fusha të rëndësishme të aktiviteteve të KPM-së dhe ka hartuar raporte përmbajtësore duke dhënë rekomandime të qarta dhe konkrete. Menaxhmenti i KPM i ka marrë me seriozitet rekomandimet e AB dhe janë në proces të adresimit të rekomandimeve të dhëna.

Po ashtu NJAB kishte raportuar në Njësinë Qëndrore Harmonizuese për periudhën Janar-Dhjetor 2014.

Njëkohësisht udhëheqësi i NJAB-së ka kryer me sukses provimet për licencim si auditor i brendshëm.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.3 Te hyrat	Paqartësi në rregulloren e brendshme për menaxhimin e të hyrave nga taksat e licencave. Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se proceset e filluara rreth ndryshim/plotësim rregullores ekzistuese të përfundohen, duke ë bërë këtë rregullore më të qartë dhe me të lehtë në zbatim.	KPM e ka hartuar rregulloren 2014 /03 e cila ka hyre në fuqi më 30.12.2014 dhe në të cilën janë adresuar sfidat në lidhje me inkasimin e të hyrave si shtyrja e afatit të pagesës, heqja e kamatave dhe çështje tjera.		
4.4 Shpenzimet me prokurim	Kryetari i Komisionit duhet të siguroj kontrole funksionale gjatë procesit të ekzekutimit të pagesave. Të gjitha format e kërkuara me rregulla të thesarit, duhet të plotësohen në mënyrë të qartë dhe kronologjike.	Në testet e kryera në auditimin e vitit 2014 ne kemi verifikuar se KPM e ka adresuar kete rekomandim plotësisht.		
4.4.3 Pagat dhe Meditjet	Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se ka harmonizuar numrin e të punësuarve në listën e pagave me numrin e stafit të lejuar me ligjin e ndarjeve buxhetore.			Përkundër përpjekjeve që KPM ka bërë ky rekomandim nuk është adresuar.